

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 Horror në fshat/ Ndjek me sëpatë komshinjtë, masakron lopët



2 Atentat si në filma/ Momenti kur 2 personat qëllojnë 45-vjeçarin në qendër të Milotit (VIDEO)



3 Kush është i riu që mori nga spitali 30 bombolat e oksigjenit e ua dërgonte banorëve! Rasti u zbulua nga spitali, u përjashtua më 11 janar



4 mbro

Aktualitet

Pallati i Marsidës trondit sërish Kavajën/ Pronari i lokalit vret klientin me plumb pas koke pas sherrit, të dy të dehur

Një vrasje me armë gjahu ka tronditur Kavajën mbrëmjen e sotme. Pas 7 orësh duke pirë në lokal, nën efektin e alkoolit pronari ka qëlluar me çifte klientin pas koke duke e lënë të vdekur në vend. Viktima është Marius Ismaili 26-vjeç, ndërsa autori është Xhevdet Lecini 60-vjeç. Ngjarja ndodhi në lagjen nr. 2 në Kavajë në katin e parë të pallatit, ku banon Marsida Qatja.

- ☐ **Autori: Kishim 7 orë që pinim, u errësova, e qëllova (Dëshmia)**
- ☐ **Drogë, plagosje dhe vjedhje, viktima e autori me precedent**

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



**Redaksia**

9 Dhjetor 2019, 18:16 | Përditesimi i fundit: 9 Dhjetor 2019, 21:05

Share 83

Tweet

**A⁺ A****Nje det me oferta te pret...****zbulo me teper ne booking.adriaferries.com**

Qyteti i Kavajës tronditet sërish nga një vrasje me armë. Mbrëmjen e sotme rreth orës 18:00 pronari i një lokali qëlloi për vdekje klientin. Viktima është Marius Ismaili 26-vjeç, ndërsa autori është Xhevdet Lecini 60-vjeç. Ngjarja ndodhi në lagjen nr. 2 në Kavajë në katin e parë ku Lecini kishte lokalin, në të njëjtin pallat ku banon Marsida Qatja (*lex*

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

10 t

Të dy të dehur, pasi kishin pirë për 7 orë, fillimisht Lecini dhe Ismaili kanë debatuar me njëri tjetrin, ndërsa më pas pronari i lokalit ka shkuar në shtëpi, në katin e tretë të pallatit ka marrë armën e

gjahut që kishte me leje dhe në momentin që ka hyrë në lokal e ka qëlluar me një plumb pas koke të riun duke e lënë të vdekur në vend. Pas ngjarjes, autori nuk ka bërë rezistencë, por është dorëzuar vetë në polici.

[Sh]
com



LEXO EDHE:

DINAMIKA e krimit në Kavajë/ Viktima nuk pagoi birrën dhe shau autorin nga gruaja e vajza! ...fjalët e fundit që tha para se të vdiste

Report TV -Pallati i Marsidës trondit sërish Kavajën...



Share 0



Të dy, autori dhe viktima nuk janë të panjohur për policinë e qytetit të Kavajës. Një burim nga grupi hetimor i tha Report Tv se viktima kohët e fundit ka qenë shoqëruar disa herë në polici pasi dyshohej se ishte shpërndarës droge, ndërsa në vitin 2012 ka qenë i arrestuar për vjedhje dhe tentativë vrasje së bashku me një tjetër person. Probleme me autorin ka pasur edhe në vitin 2011, kur ka qenë i arrestuar për pranosje, por Lecini pretendonte se e kishte bërë për vetëmbrojtje.

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

Raportuan për Shqiptarja.com gazetarët Artur Korriku, Arsen Rusta dhe Xhensila Kodra.



Report TV -Të dehur u zunë, 60 vjeçari vret me arm...



Share 0



Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:37

Vrasja në Kavajë, flet autori: Kishim 7 orë që pinim, u errësova dhe e qëllova

Report Tv zbardh dëshminë e autorit të vrasjes në Kavajë mbrëmjen e sotme. Xhevdet Lecini 60-vjeç me duart në kokë i shokuar për atë që ndodhi është shprehur para grupit hetimor se me viktimen dhe një tjetër person kishin që prej orës 11:00 të paradites së sotme dhe deri kur ndodhi ngjarja që pinin së bashku në lokal, ndërsa shkak i ngjarjes ka qenë një debat që degjeneroi nga sharjet në përdorimin e armës. "Kemi qenë të pirë, ishim prej orës 11:00 në tavolinë. Nuk e di si ndodhi, u errësova dhe e vrava" mësohet se ka thënë Lecini. A

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

